



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJKATA KUSHTETUESE**  
**УСТАВНИ СУД**  
**CONSTITUTIONAL COURT**

---

Prishtinë, më 12 dhjetor 2011  
Nr.Ref.:RK168/11

## **AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI**

në

**Rastin Nr. KI 83/11**

Parashtruesi

**Kadri Bytyqi**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë të urdhrit të Dhomës së Posaçme nr. SCEL 09-0009, të 26 tetorit 2010**

### **GJKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKES SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar  
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar  
Robert Carolan, gjyqtar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almira Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare  
Ivan Cukalovic, gjyqtar  
Gjylieta Mushkolaj, gjyqtare dhe  
Iliriana Islami, gjyqtare

#### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Parashtruesi i kërkesës është z. Kadri Bytyqi me vendbanim në Hoqë të Qytetit, Komuna e Prizrenit.

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesi i kërkesës konteston urdhrin e Dhomës së Posaçme nr. SCEL 09-0009, të 26 tetorit 2010, i cili i është dorëzuar ati më 30 tetor 2010.

## **Objekti i çështjes**

3. Kërkesa e parashtruesit ka të bëjë me shkelje të supozuar të nenit 23 [Dinjiteti i Njeriut], 24 [ Barazia para Ligjit] dhe nenit 55 (Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (më tutje: “Kushtetuta”).

## **Baza juridike**

4. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 22 i Ligjit dhe Rregulli 56(2) i Rregullores.

## **Procedura në gjykatë**

5. Më 20 qershor 2011 parashtruesi i kërkesës dorëzoi Kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (me tutje: “Gjykata”).
6. Më 21 qershor 2011, Gjykata ka kërkuar nga Parashtruesi që të dorëzojë urdhrin e Dhomës së Posaçme SCEL 09-0009, të 26 tetorit 2011 së bashku me fletëpranimin e urdhrin në fjalë që i është dorëzuar ati.
7. Më 29 qershor 2011, parashtruesi ka dorëzuar përgjigjen në kërkesë.
8. Më 17 gusht 2011, Kryetari, me vendimin Nr. GJR. 83/11, caktoi gjyqtarin Robert Carolan Gjyqtar Raportues. Po të njëjtën ditë, Kryetari, me vendimin Nr. KSH. 83/11, caktoi Kolegjin Shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve: Altay Surroy (kryesues) Snezhana Butosharova dhe Ivan Cukalovic.
9. Më 25 gusht 2011, kërkesa e parashtruesit i është komunikuar Dhomës së Posaçme.
10. Më 7 shtator 2011, Parashtruesi serish ka dorëzuar përgjigje në kërkesë.
11. Më 25 nëntor 2011, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

## **Përmbledhja e fakteve**

12. Parashtruesi i kërkesës ka punuar kuzhinier në ndërmarrjen shoqërore NHT “Theranda” në Prizren duke filluar nga 7 korriku 1983 deri me 31 korrik 1995 dhe përsëri ka vazhduar punën nga 21 qershori 1999 deri më 18 nëntor 2002, deri në ndërprerjen e kontratës nga ndërmarrja në fjalë.
13. Më 21 janar 2002, NHT “Theranda” nëpërmjet njoftimit Nr 16, njoftoi parashtruesin se me 18 nëntor 2002 do t’i ndërpritet marrëdhënia e punës edhe pse parashtruesit kontrata i skadonte me 20 janar 2003.
14. Më 26 tetor 2010, Dhoma e Posaçme lëshoi urdhrin nr. SCEL-09-0009 dhe i është përgjigjur parashtruesit në ankesën e tij të ushtruar kundër Agjencionit Kosovar të Privatizimit. Dhoma e Posaçme bazuar në nenin 10.6 (a) të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 pohon që afti për të ushtruar të drejtën e ankesës kundër listës së punëtoreve që nuk kanë përfituar nga 20% (përqindëshi) i fondeve të ndërmarrjes NHT “Theranda” ka qenë 10 ditë dhe se ky afat kishte skaduar me 13 qershor 2009, gjersa parashtruesi ka parashtruar ankesë me 21 shtator 2010. Për këtë arsye parashtruesi

është ftuar që ti japë sqarimet dhe te ofroj prova lidhur me vonesën e parashtrimit të ankesës brenda afatit ligjor, në të kundërtën, siç ceket në urdhrin e Dhomës së Posaçme ankesa do të hidhej poshtë si e papranueshme.

### **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

15. Parashtruesi i kërkesës pretendon se, Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme me urdhrin e leshur ka shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë, duke mos e përfshire atë në listën e punëtorëve që kishin të drejtën e përfitimit të 20% (përqindëshit) të fondeve nga shitja e ndërmarrjes së privatizuar NHT "Theranda" në Prizren.

### **Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës**

16. Parashtruesi pretendon se të drejtat e tij të garantuara me Nenet 23 [Dinjiteti i Njeriut], 24 [Barazia para Ligjit] dhe nenit 55 (Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore) të Kushtetutës i janë shkelur. Gjykata, në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesit, duhet që së pari të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kërkesat e parapara me Kushtetutë, siç specifikohen më tutje në Ligj dhe Rregulloren e punës së Gjykatës.
17. Në rastin konkret, gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk ka provuar se i ka shterur të gjitha mjetet juridike efektive në dispozicion siç përcaktohen me kushtetutë, ligj dhe rregullore të punës.
18. Konstatimi i tillë, vije për faktin që Dhoma e Posaçme ka kërkuar nga parashtruesi i kërkesës që të arsyetoj dhe ofroj prova lidhur me vonesën e parashtrimit të ankesës brenda afatit ligjor, siç është përcaktuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2003/13, kundër listës së punëtorëve që nuk kanë përfituar nga 20% (përqindëshi) i fondeve të ndërmarrjes NHT "Theranda" në Prizren. Lidhur me këtë nuk ka asnjë evidencë që provon se parashtruesi i është përgjigjur kërkesës së Dhomës. Bazuar nga ky fakt, del se parashtruesi i kërkesës për çështjen e tij nuk kishte pranuar ende vendim përfundimtar dhe nuk ka argumentuar me prova që e ka shfrytëzuar mundësinë të cilën ia kishte dhënë Dhoma e Posaçme, për të arsyetuar ankesën e tij.
19. Prandaj, kërkesa konsiderohet e parakohshme për faktin që parashtruesi ka dështuar të provoj se i ka shterur të gjitha mjetet juridike në dispozicion sipas ligjit në fuqi.
20. Kriteri i shterimit të mjeteve juridike përcaktohet në nenin 47.2 të Ligjit, që thotë:

#### **Neni 47.2 [Kërkesa individuale]**

*"Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj"*

21. Arsyetimi mbi kërkesën e shterimit është që t'iu ofrojnë autoriteteve kompetente, duke përfshire gjykatat, mundësinë për të parandaluar ose për të korrigjuar shkeljet e supozuara të Kushtetutës. Rregulli bazohet në supozimin se rendi juridik i Kosovës do të sigurojë mjete efektive juridike për shkeljet e të drejtave kushtetuese (shih; Aktvendimi për Papranueshmëri: AAB-RIINVEST L.L.C., Prishtinë vs Qeverise së Republikës së Kosovës, KI 41/09 të 21 janarit 2010) dhe shih mutatis mutandis, ECHR, Selmouni v. France, no. 25 803/94, vendim i 28 korrikut 1999).
22. Mirëpo edhe sikur parashtruesi i kërkuases ti kishte shteruar të gjitha mjetet efektive juridike, kriter tjetër i rëndësishëm që parashtruesi është dashur ta plotësoj është ai i

parashtrimin të kërkesës për realizimi i një të drejte brenda afatit kohor që përcakton, Ligji dhe Rregullorja e punës së gjykatës.

23. Në rastin konkret, nga parashtruesit të kërkesës duket qartë se Urdhri i Dhomës së Posaçme nr. SCEL-09-0009, i 26 tetorit 2010, i është dorëzuar më 30 tetor 2011 parashtruesit të kërkesës. Ndërsa, parashtruesi kërkesën e tij në Gjykatën Kushtetuese e dorëzoi më 20 qershor 2011, që është më tepër se 4 muaj nga data e dorëzimit të urdhrit në fjalë. Prandaj, nga kjo del se kërkesa është dorëzuar pas afatit kohor të paraparë me nenin 49 të Ligjit, për faktin që e njëjta do të duhej të parashtrohej në Gjykatë më 1 mars 2011.
24. Për me tepër neni 49 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese qartazi thotë:

#### **Neni 49 [Afatet]**

*Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kurparashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht.*

25. Në këto rrethana, kërkesa duhet të hidhet poshtë si e paafatshme në bazë të nenit 49 të Ligjit dhe Rregullit 36(b) të Rregullores së Punës.
26. Rrjedhimisht, Kërkesa e Parashtruesit është e papranueshme bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47.2, nenin 49 të Ligjit, Rregullin 36. (a) dhe (b) të Rregullores së Punës.

#### **PËR KËTO ARSYE**

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47.2, dhe nenin 49 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, si dhe rregullin 56 (2) të Rregullores së punës, më 25 nëntor 2011, njëzëri

#### **VENDOS**

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.


**Gjyqtar Raportues**



Robert Carolan



**Kryetar i Gjykatës Kushtetuese**



Prof. Dr. Enver Hasani